

Ndue Lazri

NËN QIELLIN GRI TË DACHAUT.

Pllakë përkujtimore në nderim të viktimave shqiptare

Udhëtojmë përmes një shiu që herë-herë përziehet me fjolla dëbore. Ndërsa pejsazhi alpin përmes të cillit kalon autostrada malore është i zbardhur nga dëbora, brenda makinës, me të cilën udhëtojmë, atmosfera është e ngrohtë, me biseda, humor, batuta, madje edhe me embëlsira. Miku e kolegu ynë, Erio Korani, që një natë më parë ka patur ditëlindjen, ka sjellë një vazo me embëlsira të përgatitura nga bashkëshortja e tij për t'i ndarë me grupin tonë. Ai ka ardhur bashkë me dibranen 20-vjeçare, Lulen, aktiviste e shoqatës “Rinia” në Riva del Garda, një e re që flet disa gjuhë, që këndon ëmbël e që do luajë rolin e përkthyeses në misionin në të cilin jemi nisur. Pjesa tjerë e grupit tonë e ka kaluar natën në prehër të Alpeve, në Rovereto, në shtëpinë e Renzo Bonafinit, mikut të pandarë të aktiviteteve të Federatës FNAI. Ai dhe bashkëshortja e tij, beratsja Nereida Cristina Xhakolli, na krijuan një atmosferë të bukur mikpritëse. Pjesëtarë të grupit janë edhe anëtarja e Fondacionit “Nermin Vlora”, aktivistja e mirënjohur dhe e palodhur e diasporës, që të gjithë e njohin me emrin “nënëlokja”, Vitore Stefa Leka. Ndërsa nga bregdeti i Ligureve ka ardhur Luna Çota, e cila sapo ka përfunduar eksperiencën e saj në Festivalin e Sanremos në sfilatën e kostumeve të ndryshme. Në timon, miku dhe kolegu ynë në FNAI, djaloshi dibran me shpirt të thellë patriotik, Klodian Cami.



Misioni ynë: Shkojmë për të vendosur një pllakë përkujtimore në nderim të viktimave dhe të burgosurve shqiptarë që vuajtën në kampin e përqëndrimit në Dachau të Gjermanisë, i cili ndodhet në periferi të qytetit të Mynihut. Është një mision që Federata Nazionale e Shoqatave Shqiptare në Itali (FNAI) e ka marrë shumë për zemër e për të cilin ka punuar prej disa muajsh në marrëveshje me administratën së muzeut përkujtimor të Dachaut. Pllakën përkujtimore e ka realizuar me përkushtim në gdhendje në dru skulptori shqiptar Llesh Biba. Ajo është dërguar që një muaj më parë për miratim në administratën e muzeut.

Ndërsa kemi kaluar kufirin austriak e kemi hyrë në territorin gjerman, telefonon kërkuesi e fotografi i pasionuar, kryetari i shoqatës “La Svolta” në Bolonjë, Pirro Qendro. Ai nuk i lë të shpëtojnë momente të tilla dhe ka bërë rreth 600 kilometra rrugë për të qenë i pranishëm e për të përjetësuar në foto e video një moment të tillë. Ka arritur para nesh e dëshiron të dijë në ç’pikë të udhëtimit jemi dhe na njofton që përfaqësuesit e administratës së muzeut janë duke na pritur. Korektesa dhe përpikmëria tipike gjermane e nxitin Klodianin të shtojë ndonjë kilometër më shumë në shpejtësinë e tij. Telefonon edhe këngëtarja e mirënjohur shqiptare, Alida Hisku përfaqësuese e shoqatës së saj shqiptare në Gjermani. Ajo ka bërë mbi 500 kilometra rrugë deri në Dachau për të qenë e pranishme në këtë moment të veçantë. Edhe ajo ka

arritur përpara nesh. Ka arritur edhe shkrimtari Thanas Jorgji, autor i disa veprave, i cili punon e jeton me familjen e tij në Mynih.

Me gjithë trafikun e dendur ia arrijmë që të jemi në Dachau në orarin e caktuar.

Ceremonia është caktuar për në orën 11.00 të datës 16 shkurt 2018. Më pëlqen ta eidentoj këtë datë e orë, sepse është një moment i rëndësishëm, si për ne, ashtu edhe për ata që lanë jetën e tyre këtu apo vuajtën për vite të tëra si të burgosur, të cilëve u bëhet homazhi i parë pas 73 vjetësh që nga mbarimi i luftës dhe mbyllja e kampit famëkeq.

Në hyrje të kampit na pret drejtorja e sektorit shkencor të muzeut, Andrea Riedle. Një grua e re, simpatike, me një buzëqeshje të çiltër e ndjenjë të ngrohtë mikpritjeje.

Duke e ditur që ne vinim nga Italia, ka marrë me vete edhe Violën, një vajzë e qeshur italiane, që punon në muze e që është caktuar në rolin e përkthyeses. Duke parë që ne kishim marrë me vete përkthyesë e kishim të pranishëm edhe emigrantë shqiptarë që punonin në Gjermani, të cilët mund ta luanin atë rol, ajo me modesti deshi të tërhiqej. Por ishte e natyrshme që ne do respektonim figurën e saj për praninë në këtë event dhe ramë dakort që të ishte ajo përkthyesja.

Ceremonia zhvillohet në njërën nga sallat e muzeut, pikërisht në atë ku të gjitha shtetet që kanë patur viktimat e të internuar në këtë kamp kanë vendosur pllaka e simbole të ndryshme përkujtimore në nderim të tyre.

Përpara fillimit të saj, kërkuam nëse mund të mbanim në duar një flamur shqiptar.

Ata na e dhanë miratimin duke na thënë: “Mund ta përdorni, sepse sot është ceremonia juaj”. Kur dikush nga grupi tha që “na vjen keq që nuk kemi marrë me vete edhe një flamur gjerman për ta ekspozuar sëbashku me atë shqiptar”, na thanë që kjo nuk mund të bëhej. Këto fjalë nënëlokja Vitore i mori si një refuzim edhe të flamurit tonë dhe me lot ndër sy ju afrua Andreas duke i thënë: “Ju lutemi, në këtë flamur është edhe gjaku i atyre shqiptarëve që kanë vdekur këtu”. Andrea i rrahu butë shpatullat duke buzëqeshur e i tha: Vazhdoni, pa problem.

Dr. Andrea Riedle mbajti një fjalë përshëndetëse emocionuese. Ajo na falënderoi për këtë iniciativë dhe tha që është e para pllakë përkujtimore që vihet në nderim të viktimave shqiptare në këtë kamp. Pastaj tregoi që në këtë kamp kanë qenë të internuar 115 shqiptarë. Por nuk mund të themi se ky është numuri i saktë, sepse ka patur shqiptarë që i kanë sjellë nga Italia dhe i kanë regjistruar si italianë. Në këtë drejtim duhen bërë studime më të hollësishme e mbi baza shkencore e do dëshironim një aktivizim të studentëve shqiptarë në Universitetin e Mynihut për të bërë kërkime bashkë me ne në këtë fushë. Vetëm nga qyteti i Elbasanit, tha ajo, janë sjellë këtu 85 të internuar. Viktima shqiptare të njohura zyrtarisht janë 26, por edhe për këtë nuk mund të themi se është një numër definitiv, sepse ka patur nga ata që kanë vdekur edhe pas daljes nga kampi, në përpjekjet për të kapërcyer Alpet e për të shkuar në shtëpi, ngaqë ishin aq të lodhur, të sëmurë e të uritur. Më kujtohet veçanërisht një emër, ai i gazetarit Ali Kuçi, i cili ka qenë këtu, ka ndihmuar në krijimin e grupit të informacionit dhe nuk figuron ndër viktimat. Do të ishim të interesuar të dinim ndonjë gjë për fatin e tij pas largimit nga kampi.

Na bën përshtypje serioziteti me të cilin ka punuar administrata e muzeut për të na pritur, për ta vlerësuar këtë moment, për studimet që kanë bërë që të na flasim me

fakte e shifra konkrete. Ata na premtuan të na dërgonin së afërmi listën e gjithë të internuarve shqiptarë këtu dhe të viktimave të Dachaut.

Në emër të Federatës dhe të pjesëmarrësve në këtë ceremoni shpreha falënderimet për mundësinë që na dhanë të nderojmë viktimat shqiptare, për përpjekjet e autoriteteve gjermane për shkrirjen e klimës së ftohtë midis Gjermanisë e Shqipërisë për shkak të regjimit komunist që i kishte prerë marrëdhëniet diplomatike me Gjermaninë. Ish kancelari i Bavarisë, Franc Jozef Shtraus kishte bërë tri vizita në Shqipëri, derisa pas asaj të vitit 1988 u krijua klima e nevojshme për vendosjen reciproke të ambasadave. Falënderova edhe për faktin që ajo copë tokë gjermane në Shqipëri me emrin ambasada gjermane ishte porta e parë e mikpritjes që iu hap refugjatëve të parë shqiptarë drejt një jete të lirë e të ëndërruar. Në portën e hekurt të kampit është shkruar “Puna të bën të lirë”. Por kjo thënie është një sarkazëm përballë fatit të egër që i priste këtu të internuarit. Sot në Gjermani punojnë e jetojnë qindra mijëra emigrantë shqiptarë. Puna e tyre i bën ata të lirë e edhe krenarë për vendin nga vijnë. Alida Hisku kishte sjellë me vete një tufë me lule. I takonte asaj ta vinte atë tufë me lule, jo vetëm për faktin që kishte bërë aq rrugë për të ardhur e për t'u bashkuar me iniciativën tonë, por edhe se ka qenë një artiste e persekutuar nga regjimi komunist. Në këtë ceremoni ishim të pranishëm ne emigrantët, përfaqësues të diasporës, ishte pllaka që mbetet simbol i respektit e nderimit tonë për viktimat, ishte flamuri shqiptar që u shpalos në nderim të tyre, ishin lulet që iu bënë homazh. Mungonte vetëm shteti shqiptar, ndonëse anëtarë të qeverisë ishin njoftuar e ftuar për të ardhur. Ai shtet që për 73 vjet me radhë nuk është kujtuar ndonjëherë për t'i kujtuar e nderuar këto viktimat e këta të burgosur, vazhdon me logjikën e tij të indiferencës. As përfaqësuesit e tij, ata të konsullatës së Mynihut, që janë veç 20 km larg, nuk janë kujtuar ndonjëherë për ta. I ftuam, por ishin tepër të zënë me pritjen e dy ministrave që atë ditë ishin në Mynih në konferencën europiane të sigurisë. Po të paktën pastruesen e konsullatës mund ta çonin sa për të thënë që e vlerësuan disi këtë moment. Viktimat i vret për herë të dytë indiferenca e shtetit.

* * *

Pas ceremonisë dalim të bëjmë një vizitë në këtë kamp. Sipër nesh qielli gri i Dachaut. Kam qenë edhe dy herë të tjera në këtë kamp, madje edhe në verë. E përherë ai qiell gri. Duket sikur ngjyra gri është stampuar përjetësisht në atë qiell mbi 18 hektarët që përfshin territori i kampit, për të qenë në harmoni të përjetshme me ngjyrën gri të kapanoneve, të zhavorit, të kullave vrotjuese nga ku snajperët qëllonin të burgosurit që tentonin të arratiseshin, me kishat që kanë ngritur disa shtete në nderim të viktimave të tyre, me hirin e mbetur ende në furrat e krematoriumeve ku digjeshin kufomat e të internuarve. Pamjet e fotografive në muze e ato ndërmjet kapanoneve ku flinin të burgosurit janë impresionuese. Malet me kufoma apo me eshtra janë tronditëse, aq sa Lulja nuk arrin të vazhdojë më tej, ndërsa Vitorja, Cristina, Klodiani, Luna tronditen thellësisht përpara pamjes së krematorëve. Kisha e vogël e ndërtuar nga rusët ka një bukuri e poezi të veçantë. Ata kanë bërë gjithçka që viktimat ruse këtu të ndihen si në vatanin e vet. Për ndërtimin e kishës gjithë baza materiale është sjellë nga Rusia, deri edhe dheu ku janë mbjellur lulet,

deri edhe mështeknat (berjozkat e dashura të Eseninit) e gjithë gurët, dërrasat e kupola tipike ruse.

Ky kamp është i pari i ndërtuar nga makina luftarake e shtetit gjerman, në vitin 1933. Ai u ngrit me idenë dhe këmbënguljen e njëres nga mendjet më djallëzore e më kriminale të regjimit hitlerian, shefit të policisë sekrete SS që ishte edhe shef i policisë së Mynihut, Heinrich Himmler. Ai zgjodhi këtë fushë në periferi të Mynihut, ku më parë kishte qenë një fabrikë e prodhimit të barotit dhe municioneve që në Luftën e Parë Botërore, për ta fshehur para syve të opinionit botëror atë çka do të bëhej në këtë lager të shfarosjes në masë. Himmler e ndërtoi këtë kamp me idenë për të sjellë këtu të burgosur politikë, me qëllim “riedukimin” e tyre. Ishin kryesisht ata me ide komuniste e socialdemokrate. Por më vonë kjo u zgjerua edhe me sjelljen e ebrenjve, homoseksualëve dhe atyre të përkatësive Sint e Rom. Këtu kanë qenë 206.206 të internuar. Numuri i viktimave zyrtare është 41.500, por mendohet se shkon deri në 100.000. Deri në vitin 1944 këtu ka patur të internuar vetëm meshkuj. Dyert e tij për daljen e të burgosurve janë hapur më 25 prill 1945, pak ditë përpara rënies së Berlinit dhe kapitullimit të Gjermanisë.

Më 9 maj të vitit 1965 ish kampi u kthye në muze memorial në nderim të viktimave dhe të internuarve që kanë qenë këtu. Që nga ajo kohë ai vizitohet çdo vit nga miliona vizitorë nga e gjithë bota. Administrata dhe qendra kërkimore-shkencore e muzeut vënë në dispozicion të vizitorëve një bibliotekë me mbi 14.000 vëllime, foto e stenda të shumta muzeale dhe informacione e të dhëna për 90 përqind të viktimave dhe të dënuarve që kanë vuajtur në këtë kamp.

Dachau, ky qytet i vogël e simpatik vizitohet sot më shumë për këtë kamp famëkeq dhe mbetet gati e harruar kështjella tërheqëse e dukëve të Bavarisë me ambientet e saj gjithë lule e gjelbërim e ndërtuar që në vitin 1100.

Ndërsa mendjet djallëzore e kriminale ndërtonin kampe të tilla të terrorit e tmerrit masiv si ky kamp e që u pasua nga kampe të tjera në Mathauzen, Buchenwald e Aushwitz, hierarkët e partisë famëkeqe naziste si Göringu, Gëbelsi etj. i bënë dhuratë kryekriminelit Hitler me rastin e 50-vjetorit të lindjes kështjellën-chalet me emrin “Foleja e Shqiponjës” në Alpe midis Mynihut e Salsburgut në një lartësi mbi 1800 metra e ku ai shkonte herë pas here me Eva Braun.

Mbase gjer në ato lartësi shihej tymi i krematorëve të Dachaut, por Hitleri preferonte të zbavitej, se ai zbavitej edhe me vdekjen në masë të të tjerëve, urdhëruar nga regjimi i tij kriminal.

Por historia dhe kujtesa njerëzore nuk harron, që krime e tmerre të tilla të mos ndodhin “kurrë më”, siç është shkruar në njëren nga pllakat e vendosura diku në territorin e kampit.

Ndue Lazri